



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture,**  
**Forestry and Rural Development**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 08/2024<sup>1</sup>**  
**PËR RUAJTJEN E PYJEVE, PËRGJEGJËSITË DHE OBLIGIMET E**  
**ROJES SË PYLLIT**

<sup>1</sup>Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 08/2024 Për Ruajtjen e Pyjeve, Përgjegjësitë dhe Obligimet e Rojës së Pyllit i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 08.04.2024.

## **Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,**

Në mbështetje të nenit 37, 38, 40, nenit 42 paragrafi 5, nenit 69 paragrafi 4, dhe nenit 70 paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare Nr. 9/3 Prill 2023), nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, Shtojca I, pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), si dhe Nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, dt. 12.09.2011), Nxjerrë:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 08/2024 PËR RUAJTJEN E PYJEVE, PËRGJEGJËSITË DHE OBLIGIMET E ROJES SË PYLLIT**

#### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kompetencat, detyrimet, autorizimet dhe përgjegjësitë për ruajtjen e pyjeve në Republikën e Kosovës.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe palët përkatëse të përfshira në procesin e ruajtjes së pyjeve dhe në veçanti për rojet e pyllit, personat fizik dhe juridik që mund të bëjnë shkelje ligjore sipas dispozitave të këtij udhëzimi administrativ dhe Ligjit për Pyje.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

1.1. **Agjenci** - nënkupton Agjencinë Pyjore të Kosovës;

1.2. **Rendi pyjor** – nënkupton gjendjen e pyllit e cila siguron kushte të duhura për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin normal të tij, duke përfshirë mbrojtjen nga zjarri, sëmundjet, dëmtuesit dhe fatkeqësitë natyrore;

1.3. **Mbrojtja e pyllit** – nënkupton tërësinë e masave dhe aktiviteteve me qëllim të pengimit, ndalimit dhe mënjanimi të pasojave të dëmshme nga sëmundjet dhe dëmtuesit, insektet, brejtësit, egërsirat, kafshët, njeriu, zjarri, fatkeqësitë tjera natyrore, si dhe faktorët tjerë biotikë dhe abiotikë;

1.4. **Pylli mbrojtës** – nënkupton pyllin e përcaktuar kryesisht për qëllime mbrojtëse të vet pyllit, të tokës pyjore, pellgjeve ujore, tokave që shtrihen përreth zonave urbane, për të luftuar apo parandaluar dukuritë e gërryerjes - erozionit, ndikimit të erërave, çrregullimeve në rrjedhjet ose burimet ujore dhe sigurimin e funksioneve të tjera ekologjike;

1.5. **Grumbull pyjor** – nënkupton një sipërfaqe pyjore, homogjene sipas llojeve të drunjve, moshës, dendësisë, klasës së prodhimit, kushteve mjedisore dhe formës silvikulturore, që nuk është më e vogël se 0.50 ha;

1.6. **Prerje sanitare** - nënkupton prerjen e drunjve ose pjesë të tyre të infektuar nga patogjenet, të dëmtuar nga insektet, zjarret, kushtet atmosferike apo shkaktarë të tjerë;

1.7. **Prerja e pastër** - nënkupton largimin apo prerjen e të gjithë drunjve dominues në një grumbull pyjor, duke lënë një hapësirë në të cilën distanca mesatare ndërmjet drunjve dominues të mbetur të rritur që është më e madhe se lartësia e një druri dominues të rritur në atë vend.

1.8. **Mbledhja komerciale** – nënkupton mbledhjen dhe vjeljen e produkteve pyjore jo drunore përtej masës së përcaktuar me nenin 62 të këtij ligji. Mbledhja ose vjelja e produkteve nën këtë masë, konsiderohen si vjelje rekreative;

1.9. **Rrugë pyjore** – nënkupton rrugët brenda pyjeve dhe tokave pyjore, të cilat shërbejnë kryesisht për menaxhimin e pyllit e që mundësojnë lidhjen e sipërfaqes pyjore me rrjetin e rrugëve publike;

1.10. **Shkretërimi i pyjeve** - nënkupton çdo veprim me të cilin dobësohet plleshmëria e tokës pyjore, pamundësohet prodhimtaria ose qëndrueshmëria e pyjeve, realizimi i funksioneve pyjore dhe çdo veprim tjetër që mund të sjellë bimësi të padëshiruara, erozion, shpëlarje dhe rrëshqitje të dheut.

1.11. **Damkosje e drunjve për prerje** - nënkupton evidentimin me damkë pyjore të drunjve të përzgjedhur për prerje;

1.12. **Shënjimi i drunjve për prerje** - nënkupton evidentimin me ngjyrë, heqje lëvore apo formë tjetër të përshtatshme të drunjve të përzgjedhur për prerje;

1.13. **Produkte pyjore jo-drunore (PPJD)** – nënkupton prodhimet pyjore me prejardhje nga kafshët, bimët ose mineralet të tjera nga prodhimet drunore dhe përfshijnë kërpudhat, frutat pyjore, bimët mjekësore, mjaltin, humusin, turbën, torfën, zhavorrin, rërën, dheun, mishin e gjahut të egër dhe peshkun;

1.14. **Depot e përkohshme** - nënkupton objektin e ngritur në tokat pyjore me karakter të përkohshëm për vendosjen e produkteve pyjore, i cili pas periudhës së caktuar mund të demontohet dhe largohet nga sipërfaqja e tokës pyjore.

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë siç përcaktohen në Ligjin për Pyjet.

## KAPITULLI II RUAJTJA E PYJEVE DHE PËRGJEGJËSITË E ROJES SË PYLLIT

### Neni 4 Organizimi i ruajtjes së pyjeve

1. Ruajta e pyjeve bëhet me qëllim të mbrojtjes së pyjeve nga shfrytëzimi joligjor, dëmtimi, shkatërimi, shkretërimi dhe format tjera të shfrytëzimit joligjor të pyjeve.

2. Organizimi i ruajtjes së pyjeve ka për qëllim po ashtu mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, dëmtuesit dhe sëmundjet me origjinë fitopatologjike dhe entomologjike.
3. Ruajtjen e pyjeve private nga prerjet joligjore e bëjnë pronarët e pyjeve në pajtim me ligjin.

### **Neni 5** **Përgjegjësitë e Rojës së Pyllit**

Roja e pyllit është përgjegjës për ruajtjen e pyjeve dhe kafshëve të egra në territorin e caktuar, dhe sipas kërkesës së zyrtarit të cilit i përgjigjet në pajtim me Ligjin për Pyje dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji.

### **Neni 6** **Rajoni Pyjor dhe Përgjegjësitë e Rojës së Pyllit**

1. Roja e pyllit ngarkohet me një rajon pyjorë të caktuar nga njësia përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve brenda Agjencisë.
2. Rajonet e ruajtjes i cakton zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve në bashkëpunim me stafin përgjegjës të mbrojtjes së pyjeve sipas rregullave dhe standardeve.
3. Rajoni për një roje pylli mund të jetë prej 500 ha deri në 2000 ha, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, rrezikshmëria e dëmtimit të pyjeve, strukturës pyjore dhe rrethanave tjera specifike për ruajtje.
4. Regjistrimi i dëmeve nga prerjet joligjore, nga kafshët e egra, uzurpimet si dhe dëmet tjera të shkaktuara në pyje dhe toka pyjore brenda rajonit pyjor bëhet së paku njëherë në vit, si dhe pas çdo dorëzimi - pranimit të rajonit.
5. Në rastet kur konstatohet dëmi i theksuar që tejkalon 20 m<sup>3</sup> në pyje të larta dhe 10 m<sup>3</sup> në pyje të ulëta bëhet regjistrimi i jashtëzakonshëm i dëmeve në rajonin pyjorë dhe atë me vendim të organit përgjegjës, përgjegjësit për mbrojtjen të pyjeve apo inspektorit pyjor.

### **Neni 7** **Autorizimet dhe Detyrat e Rojës së Pyllit**

1. Ruajtja e pyllit bëhet nga roja i cili është i autorizuar që të:
  - 1.1. verifikojë identitetin e personave që gjenden duke bërë shkelje të këtij udhëzimi administrativ ose personave për të cilët dyshohet arsyeshëm se kanë bërë shkelje të tilla;
  - 1.2. kontrollojë ose ndalojë automjetet e transportit në pyje, rrugë pyjore apo rrugë tjera publike me qëllim të kontrollimit të tregtimit dhe origjinës së produkteve pyjore;
  - 1.3. kontrollojë grumbullimin e produkteve pyjore jo drunore në pyje dhe toka pyjore;
  - 1.4. ndërmarrë masa me qëllim të parandalimit të uzurpimit të pyjeve dhe tokës pyjore;
  - 1.5. ndërmarrë masa dhe veprime të tjera për të cilat është i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Roja e pyllit obligohet të prezantoj kartelën identifikuese zyrtare gjatë kryerjes së aktivitetet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Roja e pyllit ka për detyrë:

3.1. parandalimin, zbulimin, ndalimin dhe monitorimin e aktiviteteve joligjore në pyje dhe toka pyjore shtetërore, duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme.

3.2. mbikëqyrjen, monitorimin dhe raportimin e dëmeve në pyje nga dëmtuesit, sëmundjet dhe shkaktarë tjerë të cilët dëmtojnë pyjet shtetërore;

3.3. parandalimin, zbulimin dhe koordinimin në shuarjen e zjarreve pyjore;

4. Roja e pyllit ka për detyrë po ashtu që të:

4.1. ruaj nga vjedhja, shkatërrimi respektivisht dëmtimi i trungjeve të pa prera dhe të prera si dhe pjesët e trungjeve, kulturat pyjore, (pyllëzimet), tokat pyjore dhe prodhimet pyjore jo drunore;

4.2. ruaj nga dëmtimi rrugët pyjore, depot e përkohshme, objektet tjera pyjore;

4.3. informon për uzurpimet e pyjeve, tokave pyjore dhe objekteve përcjellëse;

4.4. ruaj dhe përkujdeset për mirëmbajtjen e shenjave të kufijve të jashtëm dhe të brendshëm të pyjeve, të ngastrave dhe njësive menaxhuse pyjore;

4.5. përkujdeset për mbrojtjen e kafshëve të egra si dhe objekteve në terrenet e gjuetisë;

4.6. kryej procedurën administrative të lejitimit të qarkullimit të masës drunore dhe kontrollin e transportit të prodhimeve drunore dhe jo drunore të pyjeve;

4.7. përcjellë vëzhgimin hidrologjik dhe fenologjik, frytëshmërinë e farës pyjore, paraqitjen e sëmundjeve, insekteve, dëmtuesve, fatkeqësive elementare natyrore dhe dëmtimet nga kafshët e egra, duke evidentuar dhe raportuar lidhur me këtë së paku një herë në 6 muaj;

4.8. zbaton planin e masave të përcaktuar në mbrojtjen preventive të pyjeve nga zjarret;

4.9. mirëmban pikat vrojtuese, vendos shenjat paralajmëruese dhe shenjat e ndalesave;

4.10. intervenon në rastet e paraqitjes së zjarreve pyjore apo ndezja e zjarreve të hapura me afërsi prej 500 m nga kufiri i pyjeve, si dhe shuarjen e zjarrit në fazën initiale dhe nëse i duhet ndihma urgjentisht të informon shërbimet komunale dhe territoriale zjarrfikëse, organet e emergjencës dhe të sigurisë;

4.11. ndalon kullotjen joligjore, dëmtimet nga kullotja, nxjerrjen e gurëve, zhavorrit, rërës, dheut dhe deponimet e mbeturinave në pyje pa lejen e organit përgjegjës;

4.12. informon me shkrim eprorin e drejtpërdrejt për veprimtarinë e tij;

4.13. merr pjesë në punët e kultivimit të pyjeve sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejt;

4.14. mban rregullisht dhe në mënyrë të saktë ditarin e punës në të cilin evidenton dëmet pyjore nga prerjet joligjore, sëmundjet, dhe dëmtuesit pyjor ku konstatohet vendi, koha, sasia dhe lloji i prerjes, vlera e dëmeve pyjore dhe të dhënat tjera.

- 4.15. kontrollon shfrytëzimin e pyjeve në parcelat dhe ngastrat e lejuara për shfrytëzim në pyjet publike dhe private;
- 4.16. merr masa ndaj shfrytëzimeve që tejkalojnë sasinë e lejuar të masës drunore sipas lejes për shfrytëzim apo veprimeve tjera joligjore.
- 4.17. bën ruajtjen e terrenit tjetër pyjor kur mungon roja e terrenit dhe atë me urdhrin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.
5. Në rast të shkeljeve ligjore, roja e pyllit bënë:
- 5.1. sekuestrimin e masës drunore, mjeteve dhe pajisjeve me të cilat është kryer vepra;
- 5.2. përcaktimin e dëmit të shkaktuar në pyje ose toka pyjore;
- 5.3. iniciimin e procedurave administrative dhe gjyqësore.
6. Sekuestrimi nga paragrafi 5, nen paragrafi 5.1 i këtij neni, zgjat derisa personi paguan dëmin e shkaktuar në pyje, ose deri në vendimi përfundimtar të gjykatës kompetente.

### **KAPITULLI III VEPRIMET JOLIGJORE NË PYJE DHE REGJISTRIMI I DËMEVE**

#### **Neni 8 Veprimet joligjore**

1. Veprime joligjore konsiderohen:
- 1.1. shkretërimi i pyjeve;
- 1.2. prerja joligjore e trungjeve dhe pjesëve të tij;
- 1.3. marrja joligjore e asortimenteve të stivosura (paluara);
- 1.4. nxjerrja, shkatërrimi ose dëmtimi i fidanëve në fidanishtet e reja dhe fidanët në kulturat pyjore;
- 1.5. degradimi dhe devastimi i pyjeve;
- 1.6. kullotja joligjore dhe dëmtimi i lastarëve të trungjeve të reja;
- 1.7. ngritja e objekteve, ndërtimi i rrugëve, terrenet për skijim dhe infrastrukturës tjetër pa lejen e organit përgjegjës;
- 1.8. shkatërrimi dhe dëmtimi i rrugëve, rrethojave, dhe shenjave kufizuese, sinjalizuese, ndaluese në pyje;
- 1.9. shkaktimi dhe nxitja – ndezja e zjarrit në pyjet, si dhe ndezja e zjarrit në largësi deri 500m prej kufirit pyjor;
- 1.10. vjelja joligjore, dëmtimi i prodhimeve jo drunore, si dhe grumbullimi joligjor i tyre;
- 1.11. gërmihja e dheut, nxjerrja e gurëve, zhavorrit, rërës, humusit në pyje dhe tokat pyjore pa leje të organit përgjegjës;

- 1.12. ndotja e pyllit dhe tokës pyjore, ujëvarave, burimeve tjera;
- 1.13. hapja e rrugëve pyjore pa lejen e organit përgjegjës;
- 1.14. gjuetia në pyjet publike nga personat të pa autorizuar konform Ligjit për Gjuetinë;
- 1.15. shfrytëzimi dhe qarkullimi i prodhimeve pyjore pa leje;
- 1.16. hedhja dhe deponimi i mbeturinave në pyje.

#### **Neni 9**

#### **Prerje dhe Marrje Joligjore e Drunjëve dhe Asortimenteve Drunore**

1. Prerje joligjore konsiderohet prerja e trungjeve – drunjëve që bëhet në pyje në të gjitha pronësitë pa leje, të cilat paraqesin kundërvajtje apo vepër penale;
2. Prerje joligjore konsiderohet gjithashtu dëmtimi, thyerja e majave të drunjëve, prerja e degëve dhe pjesëve të tij, sharritja, përpunimi i prodhimeve drunore dhe jo drunore pa lejen e organit përgjegjës.
3. Marrje joligjore të drunjëve – nënkuptohet, shfrytëzimi i të gjitha llojeve të asortimenteve drunore të prerë, rrëzuar, gjysmë të rrezuar dhe të mbetur, pa lejen e organit përgjegjës.

#### **Neni 10**

#### **Dëmtim Pyjor**

Dëmtim pyjor konsiderohet, heqja e lëvores së trungjeve, nxjerrja e ashklave, nxjerrja e rrëshirës, shpuarja me mjete të mprehta dhe mjete tjera konsiderohet dëmtim pyjor.

#### **Neni 11**

#### **Veprime Joligjore në Sektorin e PPJD-ve**

1. Veprime joligjore në Produkte Pyjore Jo-Drunore të pyjeve nënkuptohen:
  - 1.1. Vjelja komerciale, shkulja, dëmtimi dhe shkatërrimi i PPJD-ve, rërës, zhavorrit, gurëve;
  - 1.2. kullotjen dhe ngrënien e fryteve të dushqeve ku është e ndaluar për kullotje.
  - 1.3. mbledhjen komerciale të gjetheve për ushqim të kafshëve, farës pyjore, kërpudhave, pa lejen e organit përgjegjës.

#### **Neni 12**

#### **Dëmet në Pyje nga Zjarret**

1. Dëme të shkaktuara nga zjarret ose ndezjet e zjarrit në pyje konsiderohen:
  - 1.1. Trungjet e djegura;
  - 1.2. Trungjet e prera - rrëzuara në pyje të cilët janë djegur ose vlera e të cilëve është zvogëluar për shkak të djegies;
  - 1.3. djegëja e filizave –llastorëve natyrorë dhe kulturave të ngritura pyjore;
  - 1.4. stoqet e gjetheve të përgatitura për ushqim të kafshëve;

1.5. shkatërrimi ose dëmtimi i rrethojës, shenjave kufizuese në pyje;

1.6. dëmet tjera të funksionit të pyjeve dhe tokave pyjore.

### **Neni 13**

#### **Obligimet e Rojës së Pyllit për Përcaktimin e Vlerës së Dëmit**

1. Vlera e dëmit të shkaktuar përcaktohet për çdo lloj të dëmit dhe llogaritet sipas çmimoreve të përcaktuara me akt nënligjor të veçantë.

2. Gjatë përcaktimit të dëmit pyjor, në të njëjtën kohë të vlerësohen edhe pasojat të cilat janë shkaktuar ose mund të rrjedhin si dhe masat të cilat ndërmerren që ato të largohen apo parandalohen.

3. Pas përcaktimit veprimeve joligjore, roja e pyllit është i obliguar që:

3.1. të vërtetoj llojin e dëmit, vëllimin, vlerën e dëmit të shkaktuar, vendin, parcelën ose ngastrën dhe kohën e kryerjes;

3.2. që të siguroj materialin dëshmuar mbi dëmin dhe personin që ka shkaktuar dëmin;

3.3. pas konstatimit të prerjeve joligjore të trungjeve, roja është i obliguar të identifikoj dëmin përmes shënjitimit dhe damkimit të cungjeve me numrat rendor, çekanin për dëmet pyjore;

3.4. përgatitë dhe dorëzon fletëparaqitjen për veprë joligjore, si dhe llogaritë dëmin pyjor të cilin e shprehë në masa përkatëse - m<sup>3</sup>, m ha, copë, etj dhe në vlerë €, në përputhje me Ligjin për pyjet dhe udhëzimet administrative.

4. Vlerësimi i masës totale bëhet me tabela tarifore të përcaktuara në planet menaxhuese;

5. Nëse materiali drunor është i bartur, ndërsa cungu i drurit ka mbetur, diametri llogaritet në bazë të diametrit të cungut të drurit të prerë, duke marrë parasysh rënjën e diametrit (koeficientin e formës), dhe përdorimin e tabelave përkatëse.

6. Nëse cungu është i shkullur ose i djegur, elementet takstative për vlerësimin e dëmit merren sipas mesatares të parcelave për rreth.

7. Nëse vepra joligjore është bërë në pyjet e mbrojtura, parqet kombëtare, rezervate, llojet e mbrojtura drunore, llojet e rrezikuara, grumbujt farorë, pyllëzimet e të tjera, roja e pyllit ka për obligim të specifikoj dëmet e shkaktuara.

### **Neni 14**

#### **Obligimi i Rojës së Pyllit për Sigurimin e të Dhënave dhe Dëshmitë për personin që kryen veprimet jo ligjore**

1. Të dhënat mbi personin që ka kryer veprimet joligjore përmbajnë:

1.1. Emrin dhe mbiemrin, nofken, emrin e njërit prej prindërve, gjininë, vendbanimin, e sipas mundësisë vitin dhe vendin e lindjes, profesionin, gjendjen pronësore, gjendjen martesore.

2. Nëse këtë e ka bërë i mituri, atëherë edhe të dhënat e babait, të ëmës ose kujdestarit.

3. Dëshmi për veprimet joligjore konsiderohen:

3.1. dëshmitarët e rastit;



- 3.2. mjetet e konfiskuara;
- 3.3. fotot;
- 3.4. gjurmët e mbetura dhe të ngjashme.

### **Neni 15** **Regjistrimi i dëmeve dhe Prerjeve Joligjore**

1. Regjistrimi i prerjeve joligjore bëhet duke vendosur numrin rendor dhe shenjen e çekanit në cungun e prerë.
2. Numri rendor për secilin rajon të ruajtjes fillon çdo vit prej 1 dhe vazhdon më tutje.
3. Me numrin rendor vendoset edhe shenja e çekanit të pyjeve të cilin e mbanë me veti roja e pyllit.
4. Me të njëjtin çekan në pjesën tjetër të tij damkoset edhe materiali i prerë në mënyrë joligjore, e që nuk është transportuar.
5. Të dhënat e llogaritura mbi dëmin e shkaktuar regjistrohen në ditarin e punës dhe barten në librin e cungjeve.
6. Nëse dëmi i konstatuar nuk është arsyetuar me fletëparaqitje nga pylltari përgjegjës, ngritët procedura disiplinore ndaj të njëjtit.

### **Neni 16** **Periudha Kohore e Regjistrimit të Dëmit dhe Mekanizmi Institucional**

1. Regjistrimi i dëmeve në rajonet pyjore bëhet së paku një (1) herë në vit nga komisioni të cilin e cakton Agjencia, si dhe pas çdo ndërrimi të rajoneve, dorëzim pranimit, largimit, suspendimit apo vdekjes së rojës të pyllit.
2. Me regjistrimin e të dhënave në rajonet përkatëse, nëse vërtetohet dallimi i dëmeve faktike dhe dëmeve të arsyetuara me fletëparaqitje dhe nëse ndryshimi është më i madh se 20 m<sup>3</sup> në pyjet e larta (trungishte) respektivisht 10 m<sup>3</sup> në pyjet e ultë (cungishte) iniciohet procedura disiplinore ndaj rojës së pyllit dhe personave përgjegjës.

## **KAPITULLI IV** **KONTROLLI MBI DAMKOSJEN, PRERJEN DHE TRANSPORTIN E** **ASORTIMENTEVE DRUNORE**

### **Neni 17** **Veprimet Kontrolluese të Rojës së Pyllit**

Roja e pyllit është i detyruar të bëjë kontrollin e damkosjes, prerjes, rrëzuerjes, asortimit të trungjeve dhe transportin e asortimenteve drunore dhe prodhimeve tjera pyjore në pyjet publike dhe pyjet private.

### **Neni 18** **Mënyra e Kontrollimit**

1. Kontrolli i prerjeve bëhet me verifikimin e ekzistimit të damkës pyjore në cungjet e asortimentit drunor të prera në bazë të lejes për prerje në ngastra përkatëse.

2. Kontrolli i transportit bëhet me verifikimin e ekzistimit të damkës së transportit dhe dokumentacionit përkatës të lëshuar nga zyrtari i Agjencisë.

3. Asortimenti i cili transportohet apo vihet në qarkullim të mëtejme duhet:

3.1. të jetë i damkosur me damkë përkatëse;

3.2. të ketë fletë përcjellëse përkatëse si në vijim - vendi i quajtur, numri i ngastrës, lloji i asortimentit, sasia, lloji i drurit, koha, nënshkrimi i zyrtarit përgjegjës dhe transportuesit, lloji i automjetit dhe targat e regjistrimit si dhe destinimi - relacioni i transportit dhe detaje tjera të parapara me akte nënligjore që rregullojnë çështjen e transportit.

4. Asortimentet drunore dhe prodhimet e tjera pyjore në qarkullim - transportim për të cilat nuk ekziston leje e transportit dhe nuk janë të damkosura në mënyrë të duhur, roja e pyllit sekuestron me procesverbal dhe i vendos në depon e përcaktuar.

5. Për materialin e sekuestruar, roja e pyllit harton procesverbalin me të dhënat e nevojshme për personin të cilit i është sekuestruar materiali drunor dhe mjetet tjera me të cilat është bërë preja apo transporti i materialit, ku një kopje e procesverbalit i dorëzohet kryesit të veprës.

6. Për veprimet e ndërmarra si në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni, roja e pyllit e informon shërbimin përkatës në Agjencinë dhe procedon rastin për procedurë gjyqësore.

## **KAPITULLI V**

### **PRANIM - DORËZIM I DETYRËS, UNIFORMA ZYRTARE DHE KARTELA IDENTIFIKUESE E ROJES SË PYLLIT**

#### **Neni 19**

#### **Dorëzim - Pranimi i Detyrës**

1. Me rastin e fillimit respektivisht përfundimit të kryerjes së punëve dhe detyrave në ruajtjen e pyjeve dhe tokës pyjore në rajonin pyjor të caktuar, bëhet dorëzim - pranimi i detyrës nga ana e komisionit të caktuar nga zyrtari përgjegjës i Agjencisë.

2. Komisioni për dorëzim-pranim të rajonit pyjor harton procesverbalin me të dhënat për gjendjen e rajonit pyjor i cili nënshkruhet nga 2/3 e anëtarëve të komisionit.

3. Procesverbali sipas këtij neni hartohet në 4 ekzemplarë të njëjtë nga të cilët nga një (1) ekzemplar i dorëzohet:

3.1. dorëzuesi dhe pranuesi i terrenit;

3.2. administratës, dhe

3.3. arkivit.

#### **Neni 20**

#### **Uniforma Zyrtare e Rojës së Pyllit**

1. Roja i pyllit pajiset me uniformë zyrtare të cilën është i obliguar ta mbajë gjatë kryerjes së punëve zyrtare.

2. Uniforma zyrtare e rojës së pyllit ka emblemën, formën, dhe ngjyrën e veçantë.

3. Uniforma duhet të bartet vetëm gjatë punës zyrtare, e kurrësi jashtë orarit të punës dhe e njëjta duhet të bartet e pastër.

4. Roja i pyllit me rastin e suspendimit, ndërrimit të vendit të punës, përjashtimit nga puna, apo shkuarjes në pension është e obliguar që ta kthej uniformën zyrtare.

### **Neni 21**

#### **Forma dhe Përmbajtja e Kartelës së Identifikimit të Rojës së Pyllit**

1. Roja e pyllit identifikohet me kartelën zyrtare të identifikimit - në tekstin e mëtejshëm: kartela e identifikimit.

2. Kartela e identifikimit të rojës së pyllit dhe stafit tjetër lëshohet nga Ministria respektivisht Agjencia.

3. Roja e pyllit gjatë kontrollimit me kërkesë të palës, inspektorit, policisë, pjesëtarëve të KFOR-it dhe personave tjerë zyrtar është i obliguar ta tregoj kartelën e identifikimit.

4. Evidenca mbi kartelën e identifikimit të lëshuar për rojet e pyllit mirëmbahet nga Ministria /Agjencia.

5. Nëse roja i pyllit e humbë kartelën e identifikimit ose në ndonjë rast tjetër mbetet pa të, është i obliguar që menjëherë e më së voni brenda tri (3) ditëve të informoj përgjegjësën e mbrojtjes së pyjeve në Agjenci.

6. Nëse pushon e drejta e punës, roja e pyllit është i obliguar që menjëherë pas pranimit të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, t'ia dorëzoj kartelën e identifikimit përgjegjësit të mbrojtjes së pyjeve, i cili është i obliguar që të njëjtën ta dorëzoj në Agjenci.

7. Së bashku me kartelën identifikuese, roja e pyllit ka për obligim t'i dorëzoj edhe gjësendet e tjera me të cilat ka qenë i ngarkuar sikurse që është uniforma, damka pyjore, arma zyrtare, ditari i punës, fletë përcjelljet etj.

## **KAPITULLI VI**

### **MBAJTJA DHE PËRDORIMI I ARMËS**

#### **Neni 22**

#### **E Drejta e Rojës së Pyllit për Mbajtje të Armës Zyrtare**

1. Roja e pyllit gjatë ruajtjes së pyjeve dhe vendeve të gjuetisë mund të jetë i armatosur me armë zjarri.

2. Për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, kafshëve të egra, roja e pyjeve ka të drejtë të mbaj armën zyrtare konform ligjit për armët.

#### **Neni 23**

#### **Lloji i armës**

1. Përcaktimi i llojit të armës bëhet në bazë të rrezikshmërisë së rajonit pyjor.

2. Furnizimin me armë e kryen Ministria/Agjencia në bazë të lejes së organit kompetent dhe përmes procedurës ligjore.

3. Evidencën e ngarkimit me armë dhe municion e mban Ministria/Agjencia.

#### **Neni 24** **Orari i bartjes së armës**

1. Arma dhe municioni barten vetëm gjatë orarit të punës.
2. Numri i fishekëve të përdorur brenda një (1) viti kalendarik, duhet të arsyetohet me shkrim në Ministri/Agjenci.
3. Arma nuk mbahet në vende publike dhe në ato vende ku mund të rrezikohet shëndeti dhe jeta e personave të tjerë.
4. Roja e pyllit nuk ka të drejtë t'ia jep armen zyrtare personit të tretë.
5. Mos respektimi i bartjes së armës sipas këtij neni, bartë përgjegjësi disiplinore dhe arma i merret me procedurë.
6. Përdorimi i armës nga roja e pyllit rregullohet me Ligjin për Armët.

#### **KAPITULLI VII** **DITARI I PUNËS DHE LIBRI I CUNGJEVE**

#### **Neni 25** **Obligimi i Rojës së Pyllit**

1. Roja e pyllit është e obliguar që ta mbajë ditarin e punës dhe librin e cungjeve.
2. Në ditarin e punës roja e pyllit është i obliguar që ti regjistrojë dëmet e vërejtura dhe dukurit e rrezikimit të pyjeve nga zjarri, sëmundjet, dëmtuesit pyjor dhe aktivitetet jologjore.
3. Libri i cungjeve është dokument në të cilën roja e pyllit shënon të gjitha cungjet e gjetura që janë prerë pa damkë pyjore.
4. Ditari i punës dhe libri i cungjeve mbahet nga roja e pyllit për çdo ditë.
5. Një herë në muaj ditarin e punës dhe librin e cungjeve e kontrollon përgjegjësi i mbrojtjes së pyjeve.
6. Libri i cungjeve përmban numrin serik të faqeve dhe në fund të çdo muaji i dorëzohet përgjegjësit të mbrojtjes së pyjeve.

#### **Neni 26** **Regjistrimi i Ditarit të Punës dhe Librit të Cungjeve**

1. Ditari i punës dhe libri i cungjeve regjistrohet në regjistrin e veçantë që mbahen në Agjenci.
2. Nëse roja i pyllit mban në mënyrë të parregullt ose nuk i mban fare shënimet në ditarin e punës dhe librin e cungjeve, ai bënë shkelje të detyrave të punës dhe ndaj tij inicohet procedurë disiplinore.

3. Për mos përcjelljen e lëshimeve të rojës së pyllit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni përgjegjës in e mban përgjegjësi i mbrojtjes së pyjeve.

## **KAPITULLI VIII KUALIFIKIMI SHKOLLOR I ROJËS SË PYLLIT**

### **Neni 27**

#### **Kualifikimet për Pozitën e Rojës së Pyllit**

1. Roja e pyllit duhet të posedojë përgatitjen e mesme shkollore të pylltarisë, apo në mungesë të teknikëve pyjor në konsideratë mund të vijnë edhe ata të shkencave tjera të natyrës apo ata me përgatitje tjetër të mesme shkollore.

2. Përveç përgatitjes shkollore si në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët për roje të pyllit duhet ti plotësojë edhe këto kushte:

2.1. të ketë aftësi të plotë fizike dhe psikike;

2.2. të ketë shkathtësi punuese;

2.3. të njohë punën dhe detyrat e rojës së pyjeve;

2.4. të mos jetë i privuar nga e drejta për posedim dhe bartjen e armës zyrtare, dhe

2.5. kushtet të tjera të përshkruara në konkursin për pozitën e rojës së pyjeve.

### **Neni 28**

#### **Moszbatimi**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenit 75 të Ligjit Nr. 08/L – 173 Për Pyjet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/3 Prill 2023).

### **Neni 29**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas Publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Faton PEÇI**  
  
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



08 / 04.2024